



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 8955 prot.

Kamëz, më 15.10.2025

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim

Z. Ervin DEMO
MINISTRISË SË SHETIT PËR PUSHTETIN VENDOR
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Z. Stiljan LLAVDANITI
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE
Adresa: Bulevardi Zhan d'Ark, Ish shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Të nderuar,

Duke shprehur konsiderata për veprimtarinë që ushtroni, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", si dhe referuar shkresës sonë nr. 8878 prot., datë 22.10.2024, me lëndë: "Kërkesë për bashkëpunim", kërkojmë bashkëpunimin tuaj si më poshtë, vijon:

Bashkia Kamëz me qëllim për të siguruar shërbim cilësor dhe efektiv në kuadër të garantimit të transparencës, sigurisë së të dhënave, ofrimit të informacionit dhe shërbimeve të qeverisjes elektronike, ka ndërmarr hapat për krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), Kamëz.

Sa më sipër,

Mbështetur në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", kërkojmë bashkëpunimin tuaj institucional me qëllim kryerjen e veprimeve procedurale për nxjerrjen e aktit për krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), Kamëz.

Bashkëlidhur po ju përcjellim Draft-propozimin për "Krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV)", Bashkia Kamëz.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Rakip SULLI



AKTI I KRIJIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE SHETËTËRORE

1. Krijimin e bazës së të dhënave shetëtare të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), në Bashkinë Kamëz.
2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shetëtare DTTV është Bashkia Kamëz (BK).
3. Të dhënat e bazës shetëtare të pikës 1, të këtij vendimi, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:
 - a) të dhënat parësore të DTTV-së konsiderohen të dhënat e mbledhura nga BK, që kanë të bëjnë me:

Të dhënat parësore	Përshkrim
1. TAKSAT LOKALE	Detyrimet që i perkasin pushtetit lokal(Tarifa e Pastrimit, Taksa e Gjëlber, Taksa e Tabeles, Taksa e Nderteses, Taksa e Biznesit te Vogel, Taksa e Hotelit, Taksa e Reklames etj).
2 PARAMETRAT	Parametrat e biznesit që i identifikon vetem Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore(zenja e hapësire publike, reklamati, numer tavolinash,numer fjetje hotel etj)
3 ARKETIMET	Arketimet që janë kryer për shlyerjen e detyrimeve që i perkasin kesaj drejtorie.

- b) të dhënat dytësore të DTTV-së konsiderohen të dhënat që merren nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), dhe Regjistri Kombëtar i Biznesit (RKGJC) si më poshtë vijon:

- i. Këtu duhet të listohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash

RKGJC	QKB
1. Emër	Emër Tregtar
2. Mbiemër	Administrator
3. ID_NUMBER	NIPT
4. Datelindja	Data e regjistrimit
5. Atesia	
6. Qarku	Qarku
7. Rrethi	Rrethi
8. Bashkia/Komuna	Bashkia/Komuna
9. Rruga	Rruga
	Lloji i Aktivitetit
	Xhiro e deklaruar
	Administratoret(list nga RKGJC)
	Njesia administrative

4. Dhënës të informacionit për DTTV janë institucionet Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV), Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC).

5. Subjekte të interesuara për sistemin DTTV janë:

i. Biznes

Subjektet që zhvillojnë aktivitet brenda territorit të bashkisë.

ii. Familjaret

Familjaret e regjistruara brenda bashkisë.

iii. Pronaret/Persona Fizike/Juridike

Personat që rezultojnë pronarë për pronë që ndodhen brenda territorit të bashkisë.

6. Sistemi DTTV ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe të Qendrës Kombëtare të Biznesit .

7. Niveli i aksesimit në sistemin DTTV për subjektet e interesuara :

Subjekti i interesuar	Përshkrimi i procesit
1. Qytetar/Familjaret/Bizneset	Kredencialet e llogarisë do të shpërndahen nëpërmjet njoftim detyrimit ose mund të tërhiqen tek zyrat e DTTV-se. Nëpërmjet portalit e-albania dhe sipas proceseve të shpjeguara më lart merr shërbimin e kërkuar